



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 58 Datë 15/08/2007

PËR
MIRATIMIN E FONDIT PËR BLERJEN DHE DHURIMIN E 14
KOMPJUTERAVE PËR NXËNËSIT MATURANTE ME
REZULTATE MË TË LARTA NË SHKOLLAT E MESME TË
QYTETIT TE KORÇËS.

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Sektori i Marredhenieve me Jashte, OJF-ve dhe Koordinim-Zhvillimit, për "MIRATIMIN E FONDIT PËR BLERJEN DHE DHURIMIN E 14 KOMPJUTERAVE PËR NXËNËSIT MATURANTE ME REZULTATE MË TË LARTA NË SHKOLLAT E MESME TË QYTETIT TE KORÇËS", bazuar në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh", ligjin nr 8399 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal", Ligjin nr 9645 dt. 27.11.2006 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007", Udhëzimin nr 2 dt. 17.01.2007 të M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2007", Udhëzimin nr 353 dt.19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007", si dhe V.K.B. nr. 2 dt. 02.02.2007 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI:

1. Të miratojë fondin total prej 399000 lekë për blerjen dhe dhurimin e 14 kompjuterave për nxënësit maturante me rezultate me të larta, nga të gjithë shkollat e mesme të qytetit.

2. Ky fond do të perballohet nga fondi i kursyer nga tenderi "Ruajtja e objekteve të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007" me këtë strukturë buxheti:

Pakesohet	00.	01110	05	Art. 6022008	- 399000 lekë
Shtohet	00.	01110	05	Art. 2318600	+399000 lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Sektori i Marredhenieve me Jashte, OJF-ve dhe Koordinim Zhvillimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Raimonda NASE